



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court**

Prishtinë, 15 tetor 2010
Nr. ref.: RK 54/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti nr. KI 54/09

Ahmet Fetiu

kundër

**Vendimit A. nr. 298/2009 të Gjykatës Supreme të Kosovës
të datës 11.09.2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ahmet Fetiu, nga komuna e Gjakovës.

Vendimi i sfiduar

2. Parashtruesi kundërshton aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 298/2009 të datës 11 shtator 2009, cili i është dorëzuar Parashtruesit më 19 shtator 2009.

Çështja e lëndës

3. Më 15 tetor 2009, Parashtruesi parashtroi kërkesë tek Gjykata Kushtetuese duke kundërshtuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme A.nr. 298/2009. Përmes aktgjykimit në fjalë, Parashtruesi pretendon se i është mohuar regjistrimi i pronësisë mbi parcelën kadastrale nr. 1798 Zona Kadastrale në Gjakovë, në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

Baza juridike

4. Neni 113 (7) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: "Kushtetuta"), Neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: "Ligji"), si dhe neni 55 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: "Rregullorja").

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

5. Kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 15 tetor 2009.
6. Më 16 korrik 2010, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Dr. Gjyljeta Mushkolaj, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (Kryesues), Prof. Dr. Ivan Cukalovic, dhe Prof. Dr. Iliriana Islami i rekomandoi Gjykatës së plotë në lidhje me papranushmërinë e Kërkesës.

Faktet

7. Parashtruesi pretendon se parcela kadastrale nr. 1789 Zona Kadastrale Gjakovë është pronë e familjes së tij.
8. Prona në fjalë, sipas Komunës së Gjakovës ishte eksproprijuar më 20 gusht 1960, bazuar në Vendimin 03-4242/60. Megjithatë, bartja e pronësisë nuk ishte regjistruar në Zyrën Komunale Kadastrale në Gjakovë deri më 16 dhjetor 1998 (Vendimi 952-01-275/98).
9. Parashtruesi e kundërshtoi vendimin 952-01-1-275/98 në Entin e Gjeodezisë në Beograd. Më 24 dhjetor 1998, Enti lëshoi Vendimin nr. 03-952 – 1290/98, i cili e prishi Vendimin 952-01-1-275/98 të Zyrës Komunale Kadastrale të Gjakovës. Megjithatë, Zyra Komunale Kadastrale në Gjakovë si duket kurrë nuk e ktheu tokën në pronësi të Parashtruesit, por në vend të saj ka ndërtuar një vendparkimi dhe objekte tjera mbi atë tokë.
10. Më 22 shtator 2008, Parashtruesi u ankua pranë Zyrës Komunale Kadastrale në Gjakovë se Vendimi i Entit të Gjeodezisë në Beograd kurrë nuk u ekzekutua. Prandaj, ai kërkoi nga Zyra Komunale Kadastrale që ta regjistroj tokën në emrin e tij. Mirëpo, Zyra Komunale Kadastrale e refuzoi kërkesën e tij më 22 shtator 2008 (nr. 952-1290/98), duke cekur se, bazuar në Nenin 56 (1) të Ligjit mbi Procedurën Administrative, barra e provave bie mbi palën e interesuar. Prandaj, duke marrë parasysh se Parashtruesi nuk ka ofruar prova të plota për të mbështetur kërkesën e tij (vetëm një fotokopje të Vendimit të Entit Gjeodezik në Beograd, në vend të vendimit origjinal), kërkesa e tij u refuzua si e pabazuar.
11. Parashtruesi paraqiti ankesë ndaj Vendimit nr. 952-1290/98 të Zyrës Komunale Kadastrale pranë Gjykatës Supreme, e cila me Aktgjykimin A. nr. 298/2009 më 11 shtator 2009, vendosi se pajtohet me arsyetimin e Zyrës Komunale Kadastrale

të Gjakovës, dhe shtoi se Neni 3 (2) i Ligjit 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme mbështet të njëjtin përfundim. Gjykata Supreme gjithashtu shpjegoi se bartja e pronësisë ishte e kompletuar dhe e vlefshme sipas vendimit mbi eksproprijim nr. 03-4242/60 i datës 20 gusht 1960. Prandaj, Gjykata Supreme theksoi se regjistrimi i tokës si pronë komunale në vitin 1998 ishte vetëm çështje teknike dhe se vendimi për të rikthyer tokën do të binte ndesh me vendimin origjinal të eksproprijimit sesa ndaj përpjekjes për të regjistruar pronën në vitin 1998. Sipas Gjykatës Supreme pronësia nuk është çështje kontestuese.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme ka shkelur Nenin 31 të Kushtetutës dhe Nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Vlerësimi për pranueshmërinë e Kërkesës

13. Për të gjykuar Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësoj nëse Parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe Rregullore të Punës.
14. Në rastin në fjalë, Parashtruesi i kërkesës do duhej të prezantonte prova të mjaftueshme që tregojnë se vlerësimi i provave nga Gjykata Supreme ishte haptazi i pasaktë, duke përbërë dështim nga ana e Gjykatës Supreme për të garantuar se Parashtruesi është gjykuar në mënyrë të drejtë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës.
15. Megjithatë, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësoj ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të dhëna nga institucionet kompetente gjyqësore, përveç nëse ka prova se vendimet e tilla janë dhënë në një mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të paqartë.
16. Detyra e Gjykatës lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave Kushtetuese është që të kontrolloj nëse procedurat, në tërësinë e tyre, kanë qenë të drejta dhe në pajtueshmëri me mbrojtjen shprehimisht të përcaktuar me Kushtetutë, pra, Gjykata Kushtetuese nuk është shkallë e katërt e apelit, nuk ka juridiksion për të përsëritur procedurat gjyqësore ose t'i zëvendësoj vendimet e gjykatave të rregullta me konstatimet e veta.
17. Nuk ka prova se Gjykata Supreme ka vlerësuar provat të ofruara nga Parashtruesi në mënyrë të pasaktë. Në të vërtetë, Parashtruesi i Kërkesës ka dështuar që të arsyetojë kërkesën e tij, të argumentojë se Gjykata Supreme ka bërë shkelje të Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi gjithashtu ka dështuar t'i bashkëngjis provat e nevojshme, që do të dokumentonin se Gjykata Supreme dhe Agjencioni Kadastral i Kosovës kanë bërë shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
18. Për shkaqet e lartcekura, Gjykata gjen se Kërkesa e Parashtruesit është haptazi e pabazuar, prandaj, hedhet poshtë si e papranueshme (*shih Vendim për Papranueshmëri Lënda nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 11 shtator 2006 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 2 dhjetor 2006, 17 qershor 2010*).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 113 (7) të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit dhe Nenin 55 të Rregullores së Punës, në seancën e datës 15 tetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TA REFUZOJ kërkesën si të Papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'iu dërgohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Dr.Gjyljeta Mushkolaj, d.v.



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.